



HUG Hôpitaux
Universitaires
Genève



| | | |
|--|--------------------------|------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO | | |
|   | | |
| Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës Komora medicinskoh vestrara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo | | |
| ARKIV - ARHIV - ARCHIVE | | |
| Nr. Prot. Broj. prot. Prot. no | 929 - 1 - No page. | Nr. i faq. Br. str. No page. |
| | | Data: Datum: Date: |
| | | 01.10.2019 |
| PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA | | |

MARREVEESHJE BASHKËPUNIMI

në mes:

**Projektit: “ BASHKËPUNIMI NDËRPROFESIONAL (ICP) PËR TË
PËRMIRËSUAR SIGURINË E PACIENTËVE”**
Përfaqësuar nga HUG,Z. SAVORNIN Sebastien

DHE

ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS (OIK)
përfaqësuar nga Kryetari i Odës Z. Naser Rrustemaj

Lënda:

Marrëveshje Bashkëpunimi (MB) lidhet në mes të HUG në kuadër të projektit „Bashkëpunimi ndërprofesional (ICP) për të përmirësuar sigurinë e pacientëve” dhe Odës së Infermierëve të Kosovës. (OIK).

Neni 1 Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i marrëveshjes është akreditimi i aktivitetit trajnues të projektit „Bashkëpunimi ndërprofesional (ICP) për të përmirësuar sigurinë e pacientëve”!
Ky trajnim është donacion nga Hopitaux Universitaires Geneve (HUG)!

Qëllimi përgjithshëm i trajnimit është ngritja profesionale në detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e infermiereve të SHSKUK-se!

Projekti do të kontribuojë në tri Komponentë/Rezultatet e mëposhtme (objektivat specifike):

Rezultati 1: Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor dytësor dhe tretësor të trajnohen me njohuri të reja sipas standardeve të EU, në raport me ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në disa specifika të shërbimeve klinike në QKUK dhe ShSKUK.

Rezultati 2: Menaxherët në nivel të Klinikave – Spitaleve të fuqizohen dhe kryejnë funksionet e tyre të planifikimit si: resurseve humane, kënaqshmëria dhe siguria e pacientit, kushtet e punës etj.

Punëtorja do të kontribuojë me këto tema:

- Njoftimi me konceptet kyçe, strategjitë dhe mjetet (ekipi STEPPS)

- Prezantimi i HUG (organizimi, bashkëpunimi, siguria e pacientit)
- Broshura, puna ekipore dhe koordinimi i kujdesit
- Zhvillimi i protokolleve të kujdesit klinik

Neni 2

Obligimet e Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK)

1. Fasilitasi i akreditimit të profesionistëve shëndetësor të trajnuar në të gjitha komponentet e projektit
2. Të bëjë akreditimin e programeve të trajnimit sipas standardeve të Odës së Infermierëve (sipas rekomandimeve të OIK-ut)
3. Të mbështesë pjesëmarrjen e profesionistëve shëndetësor relevant në trajnime të organizuara nga këto objektiva për t'u ngritur profesionalisht dhe në fushën e menaxhimit shëndetësorë.

Neni 3

Obligimet e projektit " Bashkëpunimi ndërprofesional (ICP) për të përmirësuar Sigurinë e pacientëve "

1. Përgjegjëse për menaxhimin/ kontrollimin/financimin e përgjithshëm të projektit dhe koordinimin me akter të tjerë institucional pjesëmarrës në projekt.
2. Koordinon zbatimin e projektit të përgjithshëm sipas kornizës logjike dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.
3. Harton planin e veprimit specifik për përfshirjen e institucioneve shëndetësorë vendore publike në projekt.
4. Organizon dhe monitoron në bashkëpunim me institucionet shëndetësore relevante të gjitha komponentet e projektit.

Neni 4
Realizimi i projektit

Kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme prej 02 Tetor, 2019 dhe deri në përfundim të projektit.

Marrëveshja mund të ndryshohet/ amandamentohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve! Të dy palët kanë të drejtë të rinegociojnë marrëveshjen duke u bazuar në të drejtën e tyre të përcaktuar! Çdo modifikim i kësaj marrëveshjeje duhet bërë me nënshkrim të të dy palëve!

Neni 5
Kushtet e përgjithshme

Kjo marrëveshje bashkëpunimi përmban 3 faqe dhe është përpiluar në 4 ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga 2 ekzemplarë i marrin palët kontraktuese.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikmëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi. Kontrata hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit!

PALET

Projekti:

"Bashkëpunimi ndërfamiljar profesional (ICP) për të përmirësuar sigurinë e pacientëve"

HUG

OIK

Z. SAVORNIN Sebastien

(Udhëheqës i Ekipit)

Sébastien Savornin
Directeur adjoint
Direction des soins - HUG

Data: 01 .10. 2019



Data: 01.10.2019